



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 483, datë 31.7.2018

P Ë R

DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË JOPUBLIK, ME STATUSIN E KOLEGJIT PROFESIONAL TË LARTË, "TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, 30 e 31, pika 1, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhënie e lejes për hapjen e institucionit të arsimit të lartë jopublik, me statusin e kolegjit profesional të lartë, "Tirana Esthetics & Style School" (në vijim, kolegji profesional i lartë "TESS"), i cili ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës, shoqërisë "NLT", sh.p.k.
2. Kolegji profesional i lartë "TESS" të organizohet në dy departamente:
 - a) Departamenti i Estetikë-Nutricionit;
 - b) Departamenti i Kozmetologjisë.
3. Kolegji profesional i lartë "TESS" të ofrojë programe të studimeve jouniversitare profesionale, 1 ose 2 vite akademike, pas arsimit të mesëm.
4. Kolegji profesional i lartë "TESS" të fillojë veprimtarinë e tij, vetëm pas nxjerrjes së urdhrimit të ministrit përgjegjës për arsimin për fillimin e veprimtarisë.

5. Kolegji profesional i lartë "TESS" t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
6. Statuti i kolegjit profesional të lartë "TESS" miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.
7. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të ushtrojë kontroll periodik të ligjshmërisë në institucion, sipas kuadrit ligjor në fuqi.
8. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe kolegji profesional i lartë "TESS" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

LINDITA NIKOLLA

Në mungesë dhe me porosi

BESA SHAHINI



NR.PROT. 3628/1
DATË 1.8. 2018

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
KOLEGJIT PROFESIONAL TË LARTË "TESS"
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

